



Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEED)

Këshillat Gjyqësorë në Shtetet e BE-së

Prof. Wim Voermans dhe Dr. Pim Albers

*L/Archief/Intern/Middelen/Documentatie/Organisaties en
Instellingen-Këshillat e Drejtësisë në Evropë def.
verzioni mars 2003*

**Komisioni Evropian për Efikasitetin e
Drejtësisë**

(KEED)

**Këshillat Gjyqësorë në Shtetet
e BE-së**

Prof. Wim Voermans dhe Dr. Pim Albers

Parathënie

Ky raport pasqyron një studim kërkimor e krahasues i zhvilluar në Holandë në vitin 1998 dhe 1999, i cili ishte autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për përgatitje të themelimit të një këshilli gjyqësor në Holandë. Në janar të vitit 1999, Zyra e TAIEX-it e Komisionit Evropian kërkoi të dijë nëse raporti do të mund të përdorej si material bazë për një projekt në mbështetje të hyrjes së Republikës Çeke në Bashkimin Evropian. Si rezultat i kësaj kërkese, raporti është përkthyer në gjuhën angleze si dhe është shtuar një kapitull për Republikën Çeke dhe planet për themelimin e këshill gjyqësor në këtë vend.

Raporti mbi studimin ka përfunduar në janar të vitit 1999 (dhe – sa i përket pjesës së Çekisë – në maj të vitit 1999). Pas kësaj, ai i është dërguar personave kontaktues në vendet që kanë qenë subjekt i hulumtim, të cilave u është kërkuar të bëjnë komente. Disa kontakte kanë dërguara komentet e tyre gjatë periudhës së vitit 1999 dhe 2000, të cilat janë inkuorporuar në raport.

Kjo do të thotë se raporti është i vjetërsuar në disa aspekte, por kemi menduar se materiale është mjaft interesant për ta prezantuar në formë të librit. Ky raport mund të jetë si hapi i parë në procesin që çon në një vlerësim më të gjerë dhe karakterizimin e këshillave gjyqësorë në Evropë dhe në botë.

Në vitin 2001 janë mbledhur informata lidhur me Këshillin Gjyqësor të Kroacisë në kuadër të një projekti të BE-së për administrimin e drejtësisë në Kroaci. Ky material është përdorur për të shtuar një kapitull në raport rreth këtij Këshilli.

Ne - dhe përkthyesit të cilët kanë punuar këtë botim në gjuhën angleze - mirëpresim çdo koment dhe shpresojmë se në të ardhmen ky studim do të plotësohet edhe me raporte tjera për Këshillat Gjyqësorë.

Leiden/ Hagë, shkurt 2003

Wim Voermans

Pim Albers

Përmbajtja

KAPITULLI 1.	HULUMTIM MBI KËSHILLAT GJYQËSORË NË SHTETET E BE-SË.....	9
1.1.	ARSYET E HULUMTIMIT: KËSHILLI I GJYQËSORIT NË REPUBLICËN ÇEKE.....	9
1.2.	PARIMET E REFORMËS SË GJYQËSORIT ÇEK DHE ZBATIMI I TYRE	10
1.3.	PIKA QENDRORE E HULUMTIMIT	11
1.4.	QASJA E HULUMTIMIT	11
	SHTETET E BE-SË QË DO TË PËRFSHIHEN NË HULUMTIM ...	11
	ASPEKTET QË DO TË KRAHASOHEN	12
KAPITULLI 2.	MODELET E KËSHILLAVE GJYQËSORË NË BASHKIMIN EVROPIAN	14
2.1.	MODELET E KËSHILLAVE GJYQËSORË NË EVROPËN VERIORE DHE JUGORE	14
2.2.	SHTETET ME KËSHILL GJYQËSOR SIPAS MODELIT TË EVROPËS JUGORE	14
2.3.	SHTETET ME KËSHILL GJYQËSOR SIPAS MODELIT TË EVROPËS VERIORE.....	15
2.4.	RASTE STUDIMI PËR SHEMBUJ TË MODELEVE TË NDRYSHME: EKSPERIENCAT	17
KAPITULLI 3.	SUEDIA (DOMSTOLSVERKET)	18
3.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË SUEDI	18
	ORGANIZIMI THEMELOR I GJYQËSORIT NË SUEDI	19
3.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLI PUBLIK NË SUEDI	20
3.3.	KËSHILLI GJYQËSOR SUEDEZ (DOMSTOLSVERKET): PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT	22
	MENAXHIMI I GJYQËSORIT DHE MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE	23
	NDARJA E MJETEVE BUXHETORE PËR GJYQËSORIN	24
	MENAXHIMI DHE SHPENZIMI I MJETEVE	25
	PËRGJEGJËSIA FINANCIARE	25
	MBIKËQYRJA E MENAXHIMIT.....	26
3.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, SUEDI	26
3.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË DOMSTOLSVERKET TË SUEDISË.....	27
KAPITULLI 4.	IRLANDA (SHËRBIMI GJYQËSOR)	29

4.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË IRLANDË	29
	ORGANIZIMI I GJYQËSORIT NË IRLANDË	30
4.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLI PUBLIK I PROCEDURËS SË GJYQËSORIT NË IRLANDË	31
4.3.	KËSHILLI I GJYQËSORIT IRLANDEZ (SHËRBIMI GJYQËSOR): PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT	34
	OBJEKTIVAT QË DO TË ARRIHEN ME SHËRBIMIN GJYQËSOR.....	37
4.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, IRLANDË	38
4.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË SHËRBIMIT IRLANDEZ TË GJYKATAVE	39

**KAPITULLI 5. DANIMARKA
(DOMSTOLSSTYRELSEN)..... 41**

5.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË DANIMARKË	41
	ORGANIZIMI I GJYQËSORIT NË DANIMARKË	42
5.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLI PUBLIK NË DANIMARKË	42
5.3.	KËSHILLI I GJYQËSORIT DANEZ (DOMSTOLSSTYRELSEN): PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT.....	44
5.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, DANIMARKË	46
5.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË DOMSTOLSSTYRELSEN DANEZE	47

**KAPITULLI 6. FRANCA (CONSEIL SUPÉRIEUR DE
LA MAGISTRATURE).....49**

6.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË FRANCË	49
	ASPEKTET KRYESORE TË ORGANIZIMIT TË GJYQËSORIT FRANCEZE	50
6.2.	FUSHËVEPRIMI I PËRGJEGJËSISË MINISTRORE DHE KONTROLLIT PUBLIK NË SISTEMIN FRANCEZ	53
6.3.	KËSHILLI GJYQËSOR FRANCEZ (CONSEIL SUPÉRIEUR DE LA MAGISTRATURE-CSM): PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT.....	56
	ROLI I CSM-SË NË EMËRIMET DHE AVANCIMET E GJYQËSORIT	59
	ROLI I CSM-SË NË JURIDIKSIONIN DISIPLINOR	61
6.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, FRANCË	63
6.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË <i>CONSEIL SUPÉRIEUR DE LA MAGISTRATURE</i> TË FRANCË	64

**KAPITULLI 7. ITALIA (CONSIGLIO SUPERIORE
DELLA MAGISTRATURA)65**

7.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË ITALI.....	65
	ORGANIZIMI I GJYQËSORIT NË ITALI	66

7.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLLI PUBLIK NË ITALI	67
	MBIKËQYRJA E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATAVE TË GJYQËSORIT.....	68
	BUXHETIMI I ORGANIZIMIT GJYQËSOR	69
7.3.	CONSIGLIO SUPERIORE DELLA MAGISTRATURA: PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT.....	70
	ANËTARËT JO-GJYQËSOR NË CSM-NË ITALIANE	71
	E ARDHMJA	72
	ROLI I CSM-SË NË EMËRIMIN, PROMOVIMIN DHE CAKTIMIN.....	72
	ROLI I CSM-SË NË JURIDIKSIONIN DISIPLINOR	75
	KOMPETENCAT TJERA TË CSM-SË	75
7.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, ITALI	76
7.5.	PASQYRË KRAHASUESE: DETYRAT DHE KOMPETENCAT E CSM-SË ITALIANE	77

KAPITULLI 8. REPUBLIKA ÇEKE79

8.1.	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË REPUBLIKËN ÇEKE	79
	ORGANIZIMI I GJYQËSORIT NË REPUBLIKËN ÇEKE	79
8.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLLI PUBLIK NË REPUBLIKËN ÇEKE	82
8.3.	‘KËSHILLI GJYQËSOR SUPREM’ NË REPUBLIKËN ÇEKE	85
8.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, REPUBLIKA ÇEKE	88
8.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË ‘KËSHILLIT GJYQËSOR SUPREM’ NË REPUBLIKËN ÇEKE	90

KAPITULLI 9. KROACIA (KËSHILLI GJYQËSOR SHTETËROR)78

9.1	POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË KROACI	78
9.2	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE NË KROACI	80
9.3	KËSHILLI GJYQËSOR SHTETËROR NË KROACI: PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT	81

KAPITULLI 10. NGA NJË MODEL I TËRËSISHËM NË NJË KËSHILL GJYQËSOR: HOLANDA97

10.1.	HOLANDA DHE POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT	97
	A. PËRSE HOLANDA?	97
	B. POZITA KUSHTETUESE E GJYQËSORIT NË HOLANDË	97
10.2.	PËRGJEGJËSIA MINISTRORE DHE KONTROLLI PUBLIK NË HOLANDË	98
10.3.	KËSHILLI GJYQËSOR NË HOLANDË	100
	A. RISHIKIM I ORGANIZIMIT TË GJYQËSORIT NË HOLANDË	100

	B. KËSHILLI GJYQËSOR I HOLANDËS	102
10.4.	KONKLZIONI PRELIMINAR, HOLANDË	104
10.5.	PASQYRË KRAHASUESE E DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NË HOLANDË	104
KAPITULLI 11.	KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	106
11.1.	MËSIME NGA PËRVOJAT ME KËSHILLAT TJERË GJYQËSORË TË EVROPËS?	106
11.2.	THEMELIMI I KËSHILLAVE GJYQËSORË NË EVROPË	106
11.3.	KËSHILLAT E RI TË GJYQËSORIT SIPAS MODELIT TË EVROPËS VERIORE	107
11.4.	MOTIVET PRAKTIKE APO MOTIVET IDEALE PËR MONITORIM TË CILËSISË	108
11.5.	PROMOVIMI I PAVARËSISË	109
11.6.	RREGULLIMI KUSHTETUES	109
11.7.	KËSHILLAT GJYQËSOR ME PËRBËRJE TË GJERË.....	110
11.8.	ANËTARËT E ‘JASHTËM’ NË ADMINISTRATË	110
11.9.	DETYRAT DHE KOMPETENCAT E PËRSHKRUARA GJERËSISHT.....	111
11.10.	VEPRIMI I KOMBINUAR I KONTROLLIT PUBLIK DHE ROLIT TË PËRGJEGJËSISË MINISTRORE	111
11.11.	REKOMANDIME PËR REPUBLIKËN ÇEKE	112
SHTOJCA A	114	
PYETËSORI A: KËSHILLI GJYQËSOR	114	
I. POZITA E KËSHILLIT GJYQËSOR	114	
II NDARJA E PËRGJEGJËSIVE MES KËSHILLIT GJYQËSOR DHE MINISTRISË SË DREJTËSISË (DREJTORIA)	116	
PYETËSORI B: MINISTRIA E DREJTËSISË	117	
I. POZITA E KËSHILLIT GJYQËSOR	117	
II POZITA E MINISTRISË SË DREJTËSISË (DREJTORIA PËRGJEGJËSE PËR ORGANIZMIN E GJYKATËS)	119	
III NDARJA E PËRGJEGJËSIVE MES KËSHILLIT GJYQËSOR DHE MINISTRISË SË DREJTËSISË (DREJTORIA)	119	
IV NDARJA E MJETEVE, LLOGARIDHËNIA DHE KONTROLLI	120	
PYETËSORI C: GJYKATAT	121	
I. POZITA E KËSHILLIT GJYQËSOR	121	
II. ORGANIZIMI I GJYKATËS	121	
III NDARJA E MJETEVE SIPAS GJYKATAVE, LLOGARIDHËNIA DHE KONTROLLI	122	
PYETËSORI D: AVOKATËT DHE STUDIUESIT LIGJORË	122	
I. POZITA E KËSHILLIT GJYQËSOR	122	
II POZITA E MINISTRISË SË DREJTËSISË (DREJTORIA PËRGJEGJËSE PËR ORGANIZMIN E GJYKATËS)	124	

III NDARJA E PËRGJEGJËSIVE MES KËSHILLIT GJYQËSOR DHE MINISTRISË SË DREJTËSISË (DREJTORIA)	124
--	-----

SHTOJCA B	126
------------------------	------------

PASQYRË E TË INTERVISTUARVE NË FRANCË, ITALI DHE SUEDI	126
FRANCA	126
ITALIA	126
SUEDIA	127

Kapitulli 11. Konkluzionet dhe rekomandimet

11.1. Mësime nga përvojat me Këshillat tjerë Gjyqësorë të Evropës?

Këshillat Gjyqësor janë produkte të zhvillimeve kulturore në një sistem ligjor, të cilat janë thellë të rrënjosura në kontekstin historik, kulturor dhe shoqëror të vendeve specifike. Kjo do të thotë se çdo Këshill Gjyqësor është unik dhe ne nuk mund t'i shohim këto borde jashtë kontekstit të tyre. Si rrjedhojë, sa i përket pyetjes se a mund të mësojmë diçka nga Këshillat Gjyqësorë të sistemeve tjera ligjore, e cila do të përgjigje tani nga Republika Çeke, është një pyetje e vështirë në shumë aspekte.

Sido që të jetë, është fakt se shembujt e shteteve të tjera nuk mund të ndiqen në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës. Përvojat e shteteve të tjera me Këshilla Gjyqësorë janë shumë të definuara për nga konteksti specifik shoqëror dhe kushtetues të këtyre shteteve si dhe të zhvillimeve kulturore nëpër të cilat ato kanë kaluar. Çdo sistem ka gjetur ekuilibrin e vet nëpërmjet "kontrolleve dhe balancimeve" specifike. Për të kuptuar vlerën dhe rëndësinë e sistemeve të vendeve tjera nevojitet njohuri e gjerë e situatës dhe historisë së tyre. Në shumë aspekte, garancat kushtetuese për administrimin e pavarur të drejtësisë dhe gjykatat e pavarura dhe format e kontrollit publik të të njëjtit sistem janë të ndërlidhura ngushtë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Republika Çeke nuk mund të gjej frymëzim në diskutimet e zhvilluara në vende të tjera evropiane lidhur me Këshillat Gjyqësorë. Këto diskutime mund të përmbajnë informacione të rëndësishëm lidhur me përvojat dhe argumentet që mund të jenë të vlefshme për diskutim nga ana Çeke. Më poshtë, do të paraqesim një studim të shkurtër të çështjeve dhe përvojave që dolën në pah, kur ishim duke përshkruar Këshillat Gjyqësorë. Këto vërejtje mund të jenë të rëndësishme si 'konfrontim' i përvojave për diskutimin çek në lidhje me organizimin e Këshillit Gjyqësor Suprem. Do të bëjmë një përmbyllje me një numër rekomandimesh që mund të jenë me vlerë për diskutimin çek.

11.2. Themelimi i Këshillave Gjyqësor në Evropë

Aspekti më i shquar i studimeve të shteteve ku është bërë ky hulumtim është se në kohën kur këto studime janë shkruar, sapo

ishin themeluan Këshilla Gjyqësorë të rinj ose do të themeloheshin së shpejti në katër shtete (Irlandë, Danimarkë, Republikë të Çekisë dhe Holandë). Në Irlandë, kjo ndodhi në vitin 1998; në Danimarkë, themelimi i Këshillit të Përkohshëm Gjyqësor është planifikuar për verën e vitit 1999, ndërsa në Republikën Çeke do të themelohet në fund të vitit 1999; në Holandë, ekzistojnë plane për të themeluar Këshillin për të hyrë në fuqi nga më 1 janar 2002. Kjo e arritur e njëkohshme nuk është krejtësisht e rastësishme. Para së gjithash – pa dyshim në Danimarkë – modeli i *Domstolsverket-it* suedez dhe përvojat e mira që kishte dëshmuar ky vend kanë qenë një frymëzim i mirë. Përpos kësaj, janë edhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës të dhëna në vitin 1994 brenda kornizës së nenit 6 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – lidhur me pavarësinë e gjyqësisë, rolin e gjyqtarëve dhe përshtatjes së administratës për drejtësi – të cilat kanë rolin e vet në këtë drejtim.¹⁵⁸ Këto rekomandime nuk nënkuptojnë që shteti duhet të kërkojë nga një bord i pavarur garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, por mund të kërkohej që, p.sh. emërimi i gjyqtarëve të bëhet në mënyrë të pavarur dhe që organizimi gjyqësor disi të ndikoj në procesin e vetë punës së tyre. Në këtë mënyrë, këto rekomandime kanë qenë pjesërisht katalizatori. Të tria shtetet, (Holanda, Danimarka dhe Irlanda) kishin një situatë ku menaxhimi dhe përkrahja e sistemit i qe besuar Ministrisë së Drejtësisë. Për nga perspektiva e garantimit të pavarësisë së gjyqësorit – siç u pa qartë nga përvoja e Suedisë – konsiderohet e rëndësishme që menaxhimi dhe përkrahja të zbatohen nga distanca. Sipas planeve daneze, irlandeze dhe holandeze, kjo është përshkruar si një përparësi e rëndësishme për një Këshill të Pavarur Gjyqësor. Kundërshtimet ndaj planit të Qeverisë suedeze në fillim të viteve të 90-ta për kthimin e kompetencave të caktuara menaxheriale nga *Domstolsverket* në përgjegjësi të Qeverisë, ilustron faktin se, pas një kohe të caktuar, vendosja e këtyre detyrave në një distancë ende konsiderohet si një garancë e rëndësishme

11.3 Këshillat e ri Gjyqësorë sipas modelit të Evropës Veriore

Paraqitja e Këshillit Gjyqësor, jo vetëm që është diçka e re, por edhe pakjoja e saj e përgjegjësisë është e tejet e mirë. Në Holandë, sikurse edhe në Danimarkë dhe Irlandë është vendosur që Këshillit Gjyqësor t'i besohen edhe detyrat administrative dhe përkrahëse (të ndryshme si trainime, akomodimi, automatizmi, sigurimi i informacionit, ndihmesë në rekrutim dhe asistencës për Komitetet këshilluese për emërimet) si dhe kompetenca në fushën e buxhetit, në ndarjen e buxhetit si dhe përgjegjësi për shpenzimet. Kështu, jo vetëm që është rritur numri i Këshillave Gjyqësorë në Evropë, por

edhe ato Këshilla të reja të formuara, të gjitha janë variante të modelit të Evropës Veriore. Padyshim, kjo deri në një masë ndodhë edhe për shkak të suksesit të Këshillit suedez dhe të modelit të tyre të dhënë. Duke ia lënë 'vetë organizatës' kompetencat menaxheriale dhe përgjegjësitë – e caktuara – buxhetore, atëherë përgjegjësia 'e vetë organizatës' për menaxhimin e organeve gjyqësore mund të zgjerohet, dhe kjo edhe më tutje çon në përmirësimin e efikasitetit. Në Suedi thuhet se kjo përgjegjësi vetanake e organizimit gjyqësor është rritur në tërësi. Shkakut i kësaj vetë-përgjegjësie më të madhe – që mund të shihet në Suedi – gjendet në paraqitjen e një organizate profesionale dhe specifike që është përgjegjëse për menaxhimin gjyqësor dhe çështjet buxhetore e cila vepron si një amortizator në mes të organizimit gjyqësor dhe qeverisë. Ky amortizator njëkohësisht paraqitet si aleat, por edhe si roje. Shkaktari i dytë i një shkalle më të madhe të vetë-përgjegjësisë në Suedi qëndron në kombinimin e administratës së pavarur, menaxhimin e organizatës gjyqësore përmes *Domstolsverket* së bashku me menaxhimin integruar nëpër gjykata. Sa i përket menaxhimit operacional, gjykatave u janë besuar mjetet e veta, që do të thotë se është mjaft e mundur që të lejohen pjesë të një vetëpërgjegjësie administrative që të implementohet nga Këshilli, përmes të gjitha llojeve të përgjegjësive të cilat i ka *Domstolsverket*. Edhe Holanda, gjithashtu ka zgjedhur këtë kombinim 'të vërtetuar' – së paku në Suedi – kombinimi i një menaxhimi nga distanca dhe menaxhimit të integruar. Sidoqoftë, Suedia është e lidhur në mënyrë të fuqishme për këtë kombinim.

11.4. Motivet praktike apo motivet ideale për monitorim të cilësisë

Sipas atyre që janë intervistuar për këtë studim Këshillat Gjyqësorë i kontribuojnë monitorimit dhe përparimit të sistemit gjyqësor. Modelet e Evropës Veriore dhe Evropës Jugore në fakt shprehin dy parime kryesore për të rritur më tej kualitetin e sistemit gjyqësor.

Në modelin e Evropës Jugore kjo ndikohet përmes sistemit të përgjegjësive të gjyqësorit mbi kualitetin që i adresohet personalitetit të gjyqtarit dhe karrierës së tij. Vendet si Franca dhe Italia i japin rëndësi rekrutimit, trajnimit, vlerësimit, emërimit, avancimit dhe transferimit, dhe përmes personalitetit të gjyqtarit gjatë gjithë karrierës së tij/saj gjyqësore, monitorimi më shumë përdoret për kualitetin e punës sesa për atë se çfarë bën një gjyqtar. Ky kontroll kryhet nga vetë gjyqtarët. Përmes ndëshkimeve disiplinore, sistemet e Evropës Jugore po ashtu kanë mundësi jo vetëm të shpërblejnë, por edhe të qortojnë. Me sistemet e

monitorimit të kualitetit sipas modelit të Këshillit Gjyqësor të Evropës Jugore, qasja zakonisht shtrihet në rrafshin 'material'. Përmes vetë-organizimit të tyre, duke mos e ndërruar ndikimin e Qeverisë, vëmendja është gjithmonë e përqendruar te nevojat e organizatave gjyqësore. Duke qenë në gjendje që në mënyrë të drejtpërdrejtë të përkujdeset për nevojat materiale direkte dhe të ketë një sistem qendror informues, sistem i fundit mundohet të arrijë kualitetin më të lartë të mundshëm të shërbimeve gjyqësore. Përmes efikasitetit të shtuar, bëhen përpjekje për ngritjen e kualitetit të administrimit të drejtësisë.

11.5. Promovimi i pavarësisë

Një stimul i rëndësishëm për themelimin e Këshillit Gjyqësor në pothuajse të gjitha shtetet e hulumtuara është promovimi i pavarësisë së gjyqësorit. Kjo pavarësi dhe statusi i pavarur i gjyqësorit nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Në Francë gjyqësori nuk ka një status të lartë, ndërsa në Itali pavarësia e gjyqësorit ka një status special: atje, gjyqësori, pikërisht për shkak të pavarësisë së dëshmuar të gjyqtarëve në të kaluarën e afërt, gëzon një prestigj të posaçëm. Sipas të anketuarve në këtë studim, Këshilli Gjyqësor i kontribuon më shumë ruajtjes sesa promovimit të pavarësisë në Itali. Efekti i favorshëm i Këshillave Gjyqësorë, pavarësisht se a bazohen në modelin e sistemit të Evropës Veriore apo asaj Jugore, mbi statusin e pavarur të gjyqtarëve dhe të organizimeve gjyqësore është qartazi i perceptueshëm në të gjitha shtetet ku është bërë hulumtimi.

11.6. Rregullimi kushtetues

Një çështje tjetër nga hulumtimet e bëra në shumicën e shteteve është dëshira për rregullim kushtetues të Këshillave Gjyqësorë. Në Francë dhe Itali kompetencat dhe pozita e Këshillit Gjyqësor janë të rregulluara me Kushtetutë. Holanda, Irlanda dhe Danimarka planifikojnë ta bëjnë të njëjtën gjë. Kjo dëshirë për një rregullim kushtetues është normale: Një Këshill Gjyqësor është një institucion i rëndësishëm, që merr rolin e vet në ndarjen kushtetuese të kompetencave shtetërore. Aspektet kryesore të ndarjes së kompetencave dhe pozitave më të rëndësishme shtetërore në vend duhet të rregullohen me të Drejtën kushtetuese.

11.7. Këshillat Gjyqësorë me përbërje të gjerë

Pothuajse të gjithë Këshillat Gjyqësorë që janë hulumtuar – me përjashtim të atij në Holandë – janë me një përbërje të gjerë prej 15 ose më shumë anëtarëve. Shumica e Këshillave përbëhen kryesisht

nga gjyqtarë të seksioneve të ndryshme të gjyqësorit. Disa prej tyre – kryesisht gjyqtarë më të lartë – janë anëtarë të Këshillit Gjyqësor sipas detyrës zyrtare, ndërsa gjyqtarët tjerë zgjidhen nga gjyqtarët. Në Francë dhe Itali, Kryetari dhe Ministri i Drejtësisë zyrtarisht janë anëtarë të bordit. Ekzistojnë dallime përkitazi me anëtarët jo-gjyqësorë (shih po ashtu 10.8). Zakonisht, këta anëtarë zgjidhen në mënyra të ndryshme nga grupe të palëve të interesit në administrimin e drejtësisë ose në Parlament. Përbërja e gjerë në përfaqësimin e Këshillit Gjyqësor nënkupton se, në parim është i prekshëm ndaj politizimit dhe sindikalizmit. Në kohë të ndryshme, balansi korrekt dhe raporti korrekt në mes të emërimit të anëtarëve të bordit mund të kuptohet në mënyrë të ndryshme ose të ketë një shtrirje tjetër. Me qëllim të ruajtjes së balansit në përpjesëtim të votimit brenda Këshillit Gjyqësor, ekzistojnë dy sisteme: së pari, kjo ka të bëjë me kushtet e emërimit (mund të emërohen vetëm ata anëtarë që përmbushin kushtet e caktuara të profesionalizmit dhe të kualitetit të përfaqësimit); së dyti, ka të bëjë me sistemin e shtrirjes së autoriteteve të emërimit (emërimi nga Parlamenti, nga Qeveria ose edhe nga të tjerët). Sistemi i fundit është i ndjeshëm sepse pa qëllim mund të shkaktojë që Këshilli Gjyqësor të jetë i përbërë vetëm nga gjyqtarët, sepse për shembull, Parlamenti dëshiron t'i emërojë gjyqtarët. Për të shmangur këtë rrezik, shumica e sistemeve përdorin të dyja sistemet për emërim.

11.8. Anëtarët e 'jashtëm' në administratë

Këshillat e Jashtëm Gjyqësorë, sikurse këto që u diskutuan më lart, praktikisht kanë të përbashkët pa përjashtime elementin e anëtarëve jo-gjyqësorë, të cilët kanë ulësen në administrim (anëtarë të jashtëm). Ky element sjell kontrollin shoqëror në Këshillin Gjyqësor. Shembujt e Francës dhe Suedisë tregojnë se në të dyja shtetet sistemi i drejtohet për votim, p.sh. avokatëve, klientëve dhe sindikatave në Këshillin Gjyqësor. Danimarka dhe Irlanda, po ashtu kanë zgjedhur këtë mënyrë, ndërsa në Republikën e Çekisë dëshira për anëtarë të jashtëm ka hasur në një konsensus të gjerë. Me kontributin e anëtarëve të jashtëm, paraqitet një sistem i kontrollit shoqëror lidhur me punën e Këshillit Gjyqësor. Në shumicën e vendeve, kontigjenti gjyqësor/*magistrates* në Këshillin Gjyqësor përbën shumicën. Prezenca e anëtarëve të jashtëm në Këshillin Gjyqësor mund të shkaktojë diskutime të shumta, siç tregon shembulli i Francës. Në Francë dhe Itali, problemet lidhur me 'politizimin' dhe 'sindikalizimin' përmes emërimeve gjyqësore synohen të zbuten përmes përpjesëtimit në bord për *magistrature*, siç duket qartë edhe nga propozimi i ndryshimeve përkitazi me përbërjen e Këshillit Gjyqësor në të dyja shtetet. Në të vërtetë, kjo

e mëparshmja më shumë e konfirmon problemin, sesa që e zgjidhë atë.

11.9. Detyrat dhe kompetencat e përshkruara gjerësisht

Ajo çka është mjaft për tu habitur për shumë rregullore për Këshillin Gjyqësor të bazuar në modelin e Evropës Veriore, është se përshkrimi i punës i këtyre bordeve në të shumtën e rasteve është I gjerë dhe se bordet shpesh i kanë vetëm disa kompetenca 'konkrete' gjyqësore. Kjo paraqitje e përshkrimeve të gjera të punës, veçanërisht në Suedi dhe Danimarkë, mund të shpjegohen me faktin se këta Këshilla Gjyqësorë janë kryesisht organizata të përgjithshme dhe teknike. Këto lehtësira ofrohen kryesisht përmes marrëveshjeve ekzistuese. Kjo është arsyeja që kompetencat nuk janë të domosdoshme të përshkruhen në mënyrë precize. Kjo do të jetë e domosdoshme vetëm kur pasojat ligjore kanë lidhje me marrëveshjet e Këshillit Gjyqësor deri në një masë substanciale. Përshkrimi i hollësishëm i punës së Këshillit Gjyqësor, për më tepër, mund të kufizojë fleksibilitetin e nevojshëm të aktiviteteve të bordit. Suedia është një shembull i një rregullimi të tillë, ku përbrenda përshkrimit të gjerë të punës, *Domstolsverket* ka zhvilluar një sistem, së bashku me gjykatat, që i përmbushë kërkesat e gjykatave duke mos qenë fare i ngurtë lidhur me atë se çfarë mund të ofrojë përmes një përshkrimi të saktë të kompetencave.

11.10. Veprimi i kombinuar i kontrollit publik dhe rolit të përgjegjësive ministrore

Sistemet juridike brenda të cilave veprojnë Këshillat Gjyqësorë, të përshkruara në këtë studim, përbëhen prej kombinimeve të ndryshme të kontrollimeve dhe balanseve kushtetuese, ku kontrolli përmes përgjegjësive ministrore zakonisht përbën vetëm njërin prej instrumenteve. Për dallim nga Franca dhe Suedia, në Holandë mënyra sipas të cilës ushtrohet kontrolli, përmes përgjegjësive ministrore mbi menaxhimin dhe buxhetin e gjyqësorit është shumë e bezdisshme - së paku në teori. Diskutimet holandeze për më shumë pavarësi dhe po ashtu diskutimet lidhur me paraqitjen e Këshillit Gjyqësor, paraprakisht bazohen në përgjegjësinë ministrore, si një instrument i kontrollit. Megjithatë, shtrohet pyetja nëse përgjegjësia e Ministrisë, si mekanizëm i kontrollit përkitazi me buxhetin dhe menaxhimin e gjykatave paraqet gjithmonë një instrument efektiv. Menaxhimi dhe buxheti për organizatat gjyqësore pothuajse nuk është ndonjë temë aktuale politike në shtetet ku është bërë studimi. Përqendrimi i diskutimeve politike ndërmjet Qeverisë dhe Parlamentit është më shumë në

ruajtjen e ligjit dhe ndjekjen e krimit. Kjo gjithashtu nënkupton se përgjegjësia ministrore si një instrument i kontrollit nuk duhet të mbivlerësohet. Shembujt e shteteve të tjera e bëjnë të qartë se, edhe nëse ka kontroll krejtësisht të ndryshëm dhe më pak të bezdisshëm mbi buxhetin dhe menaxhimin e organizatave gjyqësore përmes kontrollit ministror, ka edhe mekanizma dhe alternativa tjera të kontrollit, si publikimi, kontrolli zyrtar, mbrojtja ligjore, e cila mund të sigurohet nga kontrolli publik ose nga Këshilli Gjyqësor, sikurse edhe nga aktivitetet e menaxhimit dhe ndarjes së buxhetit për organizatat gjyqësore.

11.11. Rekomandime për Republikën Çeke

Në bazë të studimit të tanishëm dhe konkluzioneve të tij, kemi bërë këto rekomandime për themelimin dhe organizimin e Këshillit Gjyqësor Suprem në Republikën e Çekisë.

Themelimi i Këshillit Gjyqësor Suprem është në disa aspekte një instrument i përshtatshëm për të rritur më tej pavarësinë e gjyqësorit në tërësi dhe të organizimit gjyqësor në përgjithësi. Prandaj, synimi i Republikës Çeke për themelimin e Këshillit Gjyqësor Suprem meriton përkrahje.

Rekomandohet rregullimi i pozitës së Këshillit Gjyqësor Suprem me Kushtetutë, meqë kjo i përket standardizimit kushtetues dhe pozicionimit të një organi të rëndësishëm shtetëror. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se Këshilli i Përkohshëm Gjyqësor Suprem nuk do të duhej të themelohej në pritje të ndryshimit kushtetues. Shtetet tjera, po ashtu kanë zgjedhur këtë mënyrë (përfshirë Danimarkën dhe Holandën).

Kombinimi i dhënies së autoritetit menaxhial Këshillit Gjyqësor Suprem dhe mundësimin e një menaxhimi të integruar në nivel të vetë gjykatave, siguron mundësi të mëdha për bërjen e organizatave gjyqësore më efikase, siç e pamë këtë nga shembulli suedez. Në Republikën e Çekisë ky sistem ekziston deri në një masë, ku kryetarëve të gjykatave u janë besuar detyrat menaxheriale në gjykatë. Nëse kontrolli mbi këto detyra menaxheriale nuk ushtrohet më nga Ministri i Drejtësisë, por nga 'vetë' Këshilli Gjyqësor Suprem i gjykatave, atëherë ekziston një gjasë e mire për rritjen e përgjegjësisë së vetë gjykatave për menaxhim dhe efikasitet të tyre.

Një përshkrim i gjerë i kompetencave të cilat i ushtron Këshilli Gjyqësor Suprem në rrafshin që ka të bëjë me menaxhimin ka përparësinë që bordi mund të operojë në mënyrë fleksibile në atë rrafsh dhe në mënyrë dinamike mund t'i përgjigjet nevojave

aktuale të gjykatave, në çdo kohë. Në veçanti, shembulli suedez tregon se një pikëpamje e bordit e orientuar nga klienti, përmes të cilës bën testimin, sipas kërkesës së gjykatave, disa shërbime dhe lehtësira (trajtime, automatizim, administrim, etj.), mund të përbëj një kontribut të rëndësishëm për arritjen e suksesit dhe një kënaqësi për aktivitetet e Këshillit Gjyqësor Suprem.

Këshilli Gjyqësor Suprem mund të zhvillohet në një partner të rëndësishëm ndërmjetësues dhe negociues, nëse vetë ka instrumente negociuese. Në këtë mënyrë mund të parandalohet që një Këshill Gjyqësor Suprem të mos jetë tepër i varur nga Ministri i Drejtësisë. Shembulli i Danimarkës tregon se cilat kontrollime dhe balanse mund të jenë të rëndësishme për një sistem të tillë të balancuar. Në Danimarkë edhe vetë bordi mund t'i drejtohet Parlamentit, nëse kërkesat për buxhet nuk miratohen nga Ministri. Parlamenti mund të ftojë Kryesuesin e Bordit para një komisioni për të dhënë sqarime lidhur me komponentët e menaxhmentit dhe Ministri mund të suspendojë menaxhmentin e Këshillit Gjyqësor Suprem, nëse ata me vetëdije tejkalojnë buxhetin, e që mund të shkaktojë pasoja të konsiderueshme.

Në një shtet me shumë organizata gjyqësore, si në Republikën e Çekisë, rekomandohet patjetër një Këshill Gjyqësor Suprem me përfaqësim - të pjesërishëm. Me një pjesëmarrje shumicë të gjyqtarëve në ekzekutivin e Këshillit dhe një pjesëmarrje zyrtare e së paku Kryetarit të Gjykatës Supreme, po ashtu meriton të merret parasysh.

